



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1020/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Doruntina Hasani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.1020/2021, i datës 04.11.2021, parashtruar nga Doruntina Hasani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet VV 1838E/01D, VV 1824E/07R, VV 1816E/01R .

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i ka pranuar apelin Anr.1021/2021 të parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Doruntina Hasani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën pretendon se në vendvotimet VV 1838E/01D, VV 1824E/07R, VV 1816E/01R, ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Doruntina Hasani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar po nga i njëjti subjekt për të cilin është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se pretendimet nga apeli i parashtruara nga Doruntina Hasani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës janë konsumuar dhe trajtuar me vendimin Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1021/2020më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Đerić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.